



	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEQA" PEJË 
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <u>845</u>	Nr. i faq/ Br. str / V. pg <u>7</u>	
Data / Datum / Date: <u>29.03.2024</u> Pejë / Peć		

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

**RREGULLORE PËR PROCEDURAT VLERËSUESE PËR ANGAZHIMIN E
BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM NË INSTITUTIN PËR SHKENCË DHE
ARTE**

Pejë, 2024

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara me nenin 48, nenin 167, nenin 169 dhe nenin 170, të Statutit Nr. 04-V-622, 2013 të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Statutit Nr. 249/23 të Institutit për Shkencë dhe Arte, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë, Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Udhëzimit Administrativ MFPT-NR. 01 /2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 01/2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, dhe Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin - (aneksi - I - MASHT) 7/2018 e UA Nr.01/2018 parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, më datë 28.03.2024, miraton këtë:

RREGULLOREN PËR PROCEDURAT VLERESUESE PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM NË INSTITUTIN PËR SHKENCË DHE ARTE

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Institutin për Shkencë dhe Arte (në vazhdim ISHA).

Neni 2 Baza ligjore

Ligji për Arsimin e Lartë, Ligji për Veprimtarinë Kërkimore-shkencore, Statuti i UHZ-së, Statuti i ISHA-së.

Neni 3 Nevojat për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm bazohet në nevojën e sigurimit të veprimtarisë së qëndrueshme të ISHA-së në përputhje me obligimet e tij me theks të veçantë në aktivitetet si në vijim:

1. Dizajnimi i projekteve kërkimore shkencore;
2. Përgatitja dhe zbatimi i projekteve kërkimore shkencore;
3. Realizimi i kërkimeve në terren;
4. Përpunimi i të dhënave statistikore;
5. Hartimi i raporteve; dhe
6. Punë të tjera të cilat caktohen nga udhëheqësi i zyrës.

Neni 4

Periudha e angazhimit

1. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet me kontratë në kohë të caktuar me kohëzgjatje maksimale deri në 1 vit;
2. Kontrata për angazhim lidhet në përputhje me termat e referencës aktivitetit kërkimor – shkencor të caktuar;
3. I angazhuari ka për obligim që në kuadër të kontratës të realizoj aktivitetet e caktuara;
4. Kompensimi për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm përcaktohet me Rregullore të veçantë.

Neni 5

Konkursi për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm

1. Procedura e angazhimit bëhet në mënyrë transparente nëpërmjet shpalljes së konkursit publik.
2. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet për kategoritë si në vijim:
 - Personeli shkencor në marrëdhënie të rregullt pune.
 - Personeli i cili në momentin e plotësimit të moshës mandatore të pensionit ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune në ISHA dhe nëse ISHA ka nevojë për angazhimin e tyre. Angazhimi i kësaj kategorie të bashkëpunëtorëve bëhet deri në moshën e lejuar me akte të veçanta. Këshilli Shkencor nxjerr vendimin për angazhimin e kësaj kategorie për vitin përkatës.
3. Konkursi do të shpallet vetëm nëse ISHA nuk ka personel të mjaftueshëm brenda fushës përkatëse.
4. Konkursi për angazhim shpallet nga Senati i UHZ-së bazuar në rekomandimet e Drejtorit të ISHA-së.
5. Konkursi duhet ti referohet kushteve të kësaj rregulloreje.
6. Konkursi duhet të shpallet në ueb faqen e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë. Kohëzgjatja e konkursit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes.
7. Kandidatët të cilët aplikojnë duhet ti dorëzojnë të gjitha dokumentet brenda afatit të konkursit në kopje të fortë në zyrën qendrore të protokolit në Rektorat, ndërsa të skanuara në adresën elektronike apliko.isha@unhz.eu.
8. Diplomat për gradat shkencore të fituara jashtë vendit do të merren në konsideratë vetëm nëse janë njohur dhe barasvlerësuar nga MASHT-i/Zyra e NARIC-it, dhe të dorëzuara para mbylljes së konkursit.

Neni 6

Komisioni vlerësues

1. Brenda 7 ditëve pas mbylljes së konkursit, Kryesuesi i Këshillit Shkencor thërret mbledhjen e Këshillit Shkencor në të cilën merret vendimi për themelimin e komisionit vlerësues.
2. Komisioni vlerësues është organ me kredibilitet të lartë profesional, akademik dhe etik, i cili përbëhet prej tre (3) anëtarëve së paku më thirrje akademike Prof. Ass.
3. Komisioni vlerësues përbëhet prej profesorëve në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ, anëtarë të departamenteve të ISHA-së.
4. Anëtari i komisionit vlerësues me thirrje me të lartë akademike me automatizëm është kryetar i komisionit. Nëse së paku dy nga anëtarët e komisionit kanë thirrje akademike të njëjtë, kryetar do të jetë anëtari më i vjetër në moshë.
5. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të profesorëve nga departamenti në marrëdhënie të rregullt të punës, anëtar të komisionit vlerësues mund të jenë edhe personat e pensionuar, të cilët janë të angazhuar në departamentin përkatës.
6. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të profesorëve si në pikën 4 dhe 5 të këtij neni, në përbërje të komisionit vlerësues mund të emërohen edhe profesorë të tjerë që nuk janë pjesë e departamenteve të ISHA-së, por në këtë rast kryetari i komisionit duhet të jetë nga radha e profesorëve të departamentit për të cilin janë duke u vlerësuar aplikacionet.
7. Këshilli Shkencor në bashkëpunim me Drejtorin e ISHA-së duhet të ofrojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm komisionit vlerësues.
8. Kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar që të thërras mbledhjen e komisionit dhe në koordinim me anëtarët e tjerë të hartoj raportin e vlerësimit.
9. Komisioni, gjatë hartimit të raportit vlerësues, ka për obligim zbatimin e kushteve të konkursit dhe të kësaj rregulloreje.
10. Komisioni vlerësues ka për obligim shqyrtimin e aplikacionit të të gjithë kandidatëve të paraqitur për pozitën përkatëse.
11. Komisioni vlerësues ka për obligim që në raportin vlerësues t'i prezantojë të gjitha faktet relevante (në mënyrë tabelare) për të gjithë kandidatët e paraqitur në konkurs për pozitën përkatëse.
12. Komisioni vlerësues mbanë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit.

Neni 7

Kushtet e angazhimit

1. Personat e angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm nuk marrin thirrje shkencore. Angazhimi i tyre bëhet bazuar në procedurat specifike të përcaktuara me këtë rregullore.

2. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për Kërkime shkencore duhet ti plotësojnë këto kushte:
 - 2.1. Të ketë gradën shkencore Doktor i shkencave ose master i shkencave /arteve nga lëmi përkatëse (në Fakultetin e Arteve ekuivalente me të). Kandidatët të cilët krahas gradës Doktor i shkencave apo masteri i shkencave/arteve, kanë edhe thirrje shkencore apo akademike, përvojë pune në projekte hulumtuese – shkencore (dizajnim i projekteve, zbatimi i projekteve, përpunimi i të dhënave etj.) kanë përparësi.
 - 2.2. Të ketë së paku 1 publikim në revistat shkencore ndërkombëtare (në Fakultetin e Arteve së paku 1 vepër artistike të rangut ndërkombëtar në fushën përkatëse) në përputhje me kriteret e Statutit të ISHA-së dhe rregulloren në fuqi për emërimin e personelit shkencor në ISHA.
 - 2.3. Të ketë njohuri të avancuara të gjuhës angleze;
 - 2.4. Të ketë njohuri të avancuara në programe softuerike dhe përpunimin e të dhënave.

Neni 8

Rishpallja e konkursit dhe afatet

1. Konkursi mund të rishpallet nëse nuk ka aplikuar asnjë kandidat për pozitën e kërkuesit;
2. Të gjitha afatet më rastin e rishpalljes do të jenë të përgjymuara prej shpalljes së konkursit e deri të vendimi përfundimtar.

Neni 9

Afatet e vlerësimit dhe marrja e vendimit për angazhim

1. Komisioni i vlerësimit në afat prej 5 ditëve pas marrjes së vendimit për emërim, përgatit raportin vlerësues të cilin Këshilli Shkencor i ISHA-së e shqyrton në afat prej 10 ditëve pas mbylljes së konkursit.
2. Propozim-vendimi i Këshillit Shkencor së bashku me raportin e komisionit vlerësues sipas pikës 12 të nenit 6 të kësaj rregulloreje publikohet në ueb faqen e UHZ-së dhe qëndrojnë 5 ditë të publikuara.
3. Gjatë kësaj periudhës të përcaktuar në paragrafin 2, kandidatët të pakënaqur kanë të drejtë ankese e cila i drejtohet Komisionit për ankesa të themeluar nga Këshilli Shkencor.
4. Pas kalimit të afatit të ankesave, propozim-vendimet dhe vendimet për shqyrtimin e ankesave bëhen nëpërmjet Drejtorit të ISHA-së drejtuar Senatit të UHZ-së, i cili raporton për procedurën e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm të ISHA-së.

Neni 10

Procedura e shqyrtimit të propozim-vendimeve për angazhim në Këshillin Shkencor të ISHA-së

1. Këshilli Shkencor i ISHA-së shërben si organ këshillëdhënës për Senatin lidhur me rregullsinë e procedurës, afatet, prej shpalljes së konkursit, themelimit të komisioneve vlerësuese, buletin, shqyrtimit të ankesave e deri në fazën përfundimtare të angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm të paraqitur në konkurs.
2. Propozimet e komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm shqyrtohen fillimisht nga Këshilli Shkencor, i cili i rekomandon Senatit pranimin ose refuzimin e propozimit.
3. Drejtori i ISHA-së përgatit për Senat pasqyrat me propozimet përkatëse: propozimin e Komisionit Vlerësues, dhe propozimin e Këshillit Shkencor.
4. Vendimi i Senatit lidhur me propozimet e cekura në pikën 3 të këtij neni, merret më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përgatitjes së pasqyrave nga Drejtori i ISHA-së.
5. Sekretari i UHZ-së harton kontratën e punës për secilin personel të angazhuar konform vendimit të Senatit të UHZ-së.

Neni 11

E drejta e ankesës

1. Këshilli Shkencor i ISHA-së obligohet që të themeloj komisionin për shqyrtimin e ankesave lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.
2. Komisioni i ankesave i përbërë prej 3 anëtarëve emërohet nga Këshilli Shkencor dhe në përbërjen e tij nuk mund të jenë strukturat udhëheqëse të ISHA-së.
3. Kandidatët e pakënaqur me raportin e komisionit vlerësues për angazhim kanë të drejtë të paraqesin ankesë në komisionin për ankesa, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes së buletin në ueb faqen e UHZ-së.
4. Komisioni për ankesa në afat prej 5 ditësh obligohet të shqyrtojë ankesat eventuale dhe të paraqesë raportin në Këshillin Shkencor të ISHA-së.
5. Këshilli Shkencor në afat prej 3 ditëve nga marrja e raportit duhet ta shqyrtoj propozimin dhe të vendos për miratimin ose refuzimin e tij.
6. Në rast të miratimi të tij, të njëjtin e dërgon për shqyrtim dhe miratim në Senatin e UHZ-së.
7. Vendimi i Senatit është përfundimtar dhe ndaj tij nuk lejohet ankesa, por mund ta paraqesin rastin në gjykatën kompetente për konflikt administrativ.

Neni 12

Nënshkrimi i kontratës për angazhim

Senati i UHZ-së në mbledhjen e radhës shqyrton rekomandimet e Këshillit Shkencor lidhur më propozim/vendimet e komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve me angazhim për shkrimin e projekteve kërkimore dhe realizimin e kërkimeve shkencore sipas konkursit të shpallur dhe merre vendim për miratimin apo refuzimin e tyre.

Neni 13

Të drejtat dhe obligimet

1. Kandidatit të angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe kompensimin e përvojës së punës.
2. Angazhimi sipas kësaj rregulloreje nuk nënkupton themelim të marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
3. ISHA rezervon të drejtën e shkëputjes së kontratës së punës të personelit të angazhuar i cili nuk i kryen obligimet dhe përgjegjësit ndaj ISHA-së dhe studentëve si: respektimi i orarit të punës, realizimin e aktiviteteve të parapara në kuadër të pozitës së caktuar, si dhe detyra tjera që kërkohen nga Drejtori i ISHA-së.
4. Kandidatët e angazhuar bartin përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për mënyrën e shfrytëzimit të aseteve të ISHA-së.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi nga dita e miratimit në Senatin e UHZ-së.



Kryesuesi i Senatit të UHZ-së

Prof. Dr. Armand Krasniqi